

PERSONA PA DOKUMENTE, NE LUFTË!



KONTROLI
I IDENTITETIT
MBASHTA NË QENDRËN
E MBRATJES
ADMINISTRATIVE
(GRA)

UDHËZUES PËR VETËMBROJTJE
Protesta është
një e drejtë!
JURIDIKE

Fasti

Fasti
@lesfrontieres.tuent

•• Ky udhëzues ekziston
edhe në version audio

Lufta kolektive është mjet për të arritur rregullimin dhe për të kërkuar respektimin e të drejtave tona. Është e rëndësishme që çdo person pa dokumente ose me një status administrativ të pasigurt të mos mbetet vetëm, por të bashkohet me ndonjë kolektiv, shoqatë ose sindikatë.

Bashkimi është mënyra e vetme për të mbrojtur të drejtat dhe për të kërkuar respektimin e tyre. Protestimi është një e drejtë! Dhe është e rëndësishme të kujtojmë se rreziku më i madh i arrestimeve nuk është në protesta, por përreth stacioneve të trenit, transportit publik, etj.



Praktikat e luftës: disa këshilla

Para se të merrni pjesë në një aksion, mobilizim, protestë:

Njihni një avokat aktivist: në rast arrestimi, është e domosdoshme të keni një avokat. Prandaj, është e rëndësishme të njihni emrin dhe mbiemrin ose numrin e telefonit të një avokati aktivist, i cili mund t'ju këshillojë falas gjatë paraburgimit dhe të krijojë lidhjen me ekipin ligjor. Mundeni poashtu t'i shkruani informatat e avokatit në një letër dhe ta mbani me vete. Është gjithmonë më mirë të jeni të shoqëruar nga një avokat aktivist. Nëse nuk njihni ndonjë avokat, keni të drejtën të asistoheni nga një avokat i caktuar nga shteti. Kujdes, disa prej tyre nuk i njohin mirë të drejtat e të huajve dhe mund t'ju këshillojnë gabimisht. Në rast dyshimi, gjithmonë keni të drejtë të qëndroni në heshtje gjatë marrjes në pyetje.

Këshilla për t'u përgatitur kolektivisht:

- Bëni një listë të personave të pranishëm.
- Kujtoni të drejtat tuaja në rast kontrolli të identitetit.
- Përgatitni dokumentet tuaja që vërtetojnë identitetin dhe lidhjet tuaja në Francë dhe sigurohuni që një i afërm i cili nuk është i pranishëm në protestë t'i ketë ato.
- Mobilizoni dhe krijoni aleanca me mbështetës, sindikata dhe shoqata.
- Përgatitni komunikimin tuaj dhe mobilizoni median.

Gjatë mobilizimit, aksionit, protestës:

Rekomandohet të qëndroni në grup dhe të mos izoloheni. Të keni një partner gjatë protestës mund të jetë gjithashtu qetësues. Për informacion, disa veprime mund të rrisin rrezikun e arrestimit. Sipas ligjit, ato mund të konsiderohen si vepra penale dhe të justifikojnë ndalimin tuaj nga policia:

- Të mbulosh fytyrën
- Të lëvizësh mobilie urbane (koshat e plehrave, barriera, etj.)
- Të ofendosh
- Të hedhësh objekte
- Të prekësh granatat me gaz lotësjellës



Në rast problemi, rekomandohet të qëndroni në grup dhe të shmangni identifikimin e lehtë. Pas mobilizimit, aksionit, protestës:

Pas mobilizimit, aksionit, protestës:

Është e rëndësishme **të mblidheni dhe të bëni thirrjen**. Nëse dikush mungon, sigurohuni që ai/ajo është mirë.

Nëse mësoni se dikush është ndaluar në komisariat:

- Shkoni atje kolektivisht.
- Informoni sa më shumë njerëz për të ushtruar presion (grupe WhatsApp, shoqata, rrjete sociale, etj.).

ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS
LIBERTÉ D'INSTALLATION ET DE CIRCULATION POUR TOU-TE-S	E						LIBERTÉ D'INSTALLATION ET DE CIRCULATION POUR TOU-TE-S
WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM

Njohja e të drejtave tuaja në rast kontrolli të identitetit

Është **e rëndësishme të qëndroni të qetë** dhe të mos kundërshtoni fizikisht, pavarësisht provokimeve, fyërjeve dhe presionit. Këto janë këshilla, por e dimë që mund të jetë e vështirë të përballosh presionin e policisë.

Nëse nuk mund ta vërtetoni të drejtën tuaj për qëndrim në Francë gjatë një kontrolli të identitetit, mund të ndaloheni në komisariat për verifikim të statusit tuaj.

Ky kontroll mund të zgjasë disa orë, me një **maksimum prej 24 orësh (ose 48 orë nëse akuzoheni për një shkelje dhe vendoseni në paraburgim).**

Kujdes, në rast kontrolli, **është e rëndësishme të flisni për lidhjet tuaja në Francë** (puna, shkolla, strehimi, familja, miqtë...) dhe të mos lini përshtypjen se nuk do të respektoni urdhrin e largimit nga territori (OQTF), (shembull: çka mund t'i thuani policisë: “unë kam lidhje të shumta në Francë dhe dëshiroj të jetoj këtu, mirëpo nëse më jepet një vendim për t'a lëshuar vendin, do t'a respektoj”).

Nëse keni një kërkesë për rregullim të situatës civile në prefekturë, një kërkesë për azil ose një sëmundje të rëndë, është e rëndësishme ta përmendni.

Këshillohet te jepni një adresë të vetme, sipas mundësisë, adresën tuaj administrative nëse keni një vendbanim.

Policia mund të përpaket t'ju dekurajojë nga dhënia e informacioneve lidhur me situatën tuaj duke thënë se nuk rrezikoni një OQTF. Kjo nuk është e vërtetë. **Lexoni deklaratën tuaj në fund të marrjes në pyetje për t'u siguruar që gjithçka është regjistruar saktë, dhe jepni vërtetimet që keni me vete.**

ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS	ÉGALITÉ DES DROITS
LIBERTÉ D'INSTALLATION ET DE CIRCULATION POUR TOU-TE-S	E						LIBERTÉ D'INSTALLATION ET DE CIRCULATION POUR TOU-TE-S
WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM	WWW.FACTUM

Njohja e të drejtave tuaja në rast paraburgimi (GAV)

Të kesh dokumentet me vete nuk është një detyrim, **mirëpo nuk duhet kurrë të kesh pasaportën me vete për të shmangur një dëbim të shpejtë.**

Duhet vetëm të **deklaroni identitetin tuaj (emri, mbiemri, ditëlindja dhe vendlindja)** dhe ta vërtetoni me ndonjë dokument me foto (kartë transporti, patentë shoferi, etj.).

Policia mund t'ju marrë gjurmët e gishtave dhe t'ju fotografojë.

Kërkoni gjithmonë të jeni të shoqëruar nga një **avokat**, një **përkthyes** dhe të kontrolloheni nga një **mjek**. Keni poashtu të drejtë të njoftoni **një person të zgjedhur nga ju. Është e drejtë e juaj.**

Kujdes, përkthyesi e mjeku komunikojnë me policinë.

Policia do të tentojë t'ju bindë për të hequr dorë nga të drejtat tuaja: gënjeshtra (lirim më i shpejtë, dënim më i lehtë, telefonata të rrejtshme, etj.).

Mirëpo **është tejet e rëndësishme të qëndroni të heshtur lidhur me arsyen për të cilën gjendeni ne paraburgim** (aksioni, protesta, etj.).

Të gjitha pyetjet janë të rrezikshme. Një përgjigje e thjeshtë nga ana juaj sikur “po” ose “mirë” është e mjaftueshme për t’ju akuzuar.

Gjatë paraburgimit, keni të drejtë të mos thoni asgjë.

Ju mund të thoni: **“Nuk kam asgjë për të deklaruar.”**

Keni të drejtë **të mos nënshkruani asnjë dokument**, pa pasoja, edhe nëse policia mundohet t’ju bindë ndryshe.

Preferohet të keni një telefon mobil të thjeshtë pa kamerë (lloji i vetëm që lejohet me vete në Qendrën e Mbatjes Administrative).

Përmbledhje e këshillave në rast të paraburgimit:

- Jepni vetëm informatat e nevojshme (identitetin, statusin tuaj të qëndrimit)
- -Mos u përgjigjini në asnjë pyetje tjetër, për të shmangur rrezikimin tuaj ose të personave të tjerë, pasi që policia do të përpiqet t’ju manipulojë dhe të përdorë fjalët tuaja kundër jush.



Qëndrimi i parregullt nuk është krim, por mund të merrni urdhrin e largimit nga territori (OQTF) ose të rrezikoni dëbimin nëse vetëm e keni marrë tashmë një OQTF.

Nëse policia vlerëson se dokumentet tuaja të përfaqësimit (të gjithë dokumentet që provojnë lidhjet tuaja në Francë) nuk janë të mjaftueshme, se keni tashmë një Obligim për të Larguar nga Territori Francez (OQTF) ose një Ndalesë për të Kthyer në Territorin Francez (IRTF) që ka më pak se 3 vjet ose se përbëni një kërcënim për rendin publik, mund të

- Merrni një OQTF.
- Të caktoheni në arrest shtëpiak për 45 ditë.
- Të vendoseni në një qendër për mbajtje administrative (CRA) për 4 ditë (vetëm nëse jeni mbi 18 vjeç)

* Pas këtyre 4 ditëve, do të keni një seancë me një gjykatës për të vendosur nëse do të liroheni (në rast të parregullsive gjatë arrestimit, mungesës së justifikimit të mjaftueshëm për ndalimin, gjendjes shëndetësore të papërshtatshme...) ose do të mbeten në Qendrën e Mbatjes Administrative (CRA) për edhe 26 ditë të tjera. Do të keni një seancë në fund të çdo periudhe për të vendosur nëse do të vazhdojë ose jo ndalimi (për 30 ditë, pastaj përjashtimisht 15 ditë më shumë, dhe më pas 15 ditë të tjera maksimalisht)

Për të zvogëluar rrezikun e dëbimit, mbani gjithmonë një dosje me dokumentet tuaja të gatshme për të afërmit dhe avokatët tuaj, në këtë mënyrë ata do të mund t’ua përcjellin shoqatave të pranishme në Qendrën e Mbatjes Administrative (CRA).

Fokus: Përdorimi i kartave individuale të anëtarësisë

Krijimi i një karte për çdo person të kolektivit tuaj mund t’ju ndihmojë të vërtetoni identitetin dhe të dekurajoni policinë në rast kontrolli. Karta duhet të përmbajë:

- Fotografi
- Emër, mbiemër, datëlindje dhe vendlindje
- Numrin e telefonit të avokatit tuaj

Ky udhëzues është realizuar nga aktivistë të FASTI dhe ASTI, 2025. Ai është gjithashtu i disponueshëm në format audio dhe në disa gjuhë.

Na kontaktoni : www.fasti.org / [@lesfrontierestuent](https://www.facebook.com/lesfrontierestuent) / coordination@fasti.org